



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon që:

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12 dhe 17 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 154 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, nenit 9 shkronja a) dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2023, të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M

MBI PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË ZBATIMIT TË RREGULLORES PËR ORARIN E PUNËS TË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE NR.15-330/02-22376 TË DATËS 28.04.2023

- I. Me këtë Vendim **PEZULLOHET** përkohësisht zbatimi - implementimi i Rregullores për orarin e punës të veprimtarive ekonomike nr.15-330/02-22376 të datës 28.04.2023.
- II. Pezullimi i zbatimit - implementimit të Rregullores për orarin e punës të veprimtarive ekonomike nr.15-330/02-22376 të datës 28.04.2023 sipas pikës I të këtij Vendimi bëhet për kohë të caktuar deri në plotësim dhe ndryshimin e Rregullores në fjalë.
- III. Pezullim zbatimi i implementimit të kësaj Rregullore bëhet për arsye të ankesave të shumta të paraqitura me rastin e implementimit të saj.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektorat.
- V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim - Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 dhe 17 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 154 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, nenit 9 shkronja a) dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Arsyeja e pezullimit të përkohshëm të implementimit të dispozitave të Rregullores për orarin e punës të veprimtarive ekonomike nr.15-330/02-22376 të datës 28.04.2023 bëhet për arsye të vështirëve të krijuara në implementimin përkatësisht zbatimin e saj duke u bazuar në numrin e madh të ankesave të qytetarëve dhe subjekteve të ndryshme të biznesit.

Nga të cekurat më lartë, kërkohmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 330/02-31040
Lipjan, më 15.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

